MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PEQIN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Peqin me objekt: "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, prokurimet me fonde publike,realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditi i brendshëm, etj." dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 63, datë 15.5.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 152/5 , datë 15.5.2012 , dërguar **z. Ilir RRUSHI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nisur nga të metat e konstatuara, të organizohet puna në drejtorinë e financës me qëllim që të zbatohen kriteret e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontabilitetin", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlera të vogla dhe të larta", si dhe kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile".

Brenda datës 31.8.2012

2. Shpenzimet operative të programohen të argumentuara dhe të analizuara duke synuar uljen e tyre ku të mbahet parasysh kufiri monetar për artikuj dhe grup asortimentesh apo shërbime të ngjashme, me qëllim përdorimin e fondeve pa i copëzuar ato dhe shmangien e procedurave ligjore të prokurimit, si në rastet e evidentuara gjatë periudhës së kontrolluar.

Vazhdimisht

3. Me mbylljen e bilancit kontabël vjetor 2011, nga drejtoria e financës, sipas dispozitave ligjore, të kryhen sistemimet dhe të pasqyrohen në kontabilitet sipas analizave, me emërtime të sakta, vlerat reale e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara sipas inventarëve për çdo objekt. Të merren masa për vazhdimin e procedurave për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin e plotë, azhurnimin dhe marrjen në dorëzim të objekteve, pronë e Bashkisë dhe të aplikohet në ZVRPP Peqin, për regjistrimin e tyre.

Menjëherë

4. Për administrimin e letrave me vlerë të mbahet libër arke i veçantë, të administrohen me vlerën e shtypur që përmban fleta, duke u pasqyruar në kontabilitet gjendja e tyre në arkë dhe te përdoruesit me vlerën reale.

Menjëherë

5. Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore të bashkërendohet puna në Drejtorinë e financës dhe Policinë e Bashkisë për dokumentimin në kontabilitet të detyrimeve të lindura nga taksat dhe tarifat vendore që në momentin e krijimit të tyre dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i detyrimeve tatimore për vitin 2011 nga 148 subjekte në shumën 4,255 mijë lekë së bashku me kamat vonesat.

Menjëherë

6. Nga ana e Policisë së Bashkisë së bashku me Sektorin e taksave dhe tarifave vendore, të evidetohen automjetet e pa liçencuara dhe të bëhet regjistrimi i tyre, në të kundërtën të zbatohen sanksionet ligjore përkatëse.

Menjëherë

7. Në çdo rast, punimet për mirëmbajtje e rikonstruksione të objekteve të realizuara me procedurën për blerjet me vlera të vogla, të kryhen mbi bazën e projekteve, preventivave dhe situacioneve përkatëse, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse të tij.

Në vazhdimësi

8. Nga ana e Drejtorisë së Financës të Bashkisë Peqin të kryhen veprimet për pasqyrimin në kontabilitet dhe arkëtimin e vlerës 769,200 lekë si detyrim për punime të pakryera nga operatori ekonomik [redacted] në objektin "Furnizim me ujë i qytetit Peqin".

Menjëherë

9. Të merren masa për riorganizimin e Drejtorisë së Urbanistikës, për administrim të drejtë të territorit në juridiksion të Bashkisë, sipas kritereve dhe rregullimeve të përcaktuara me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar**.**

Menjëherë

10. Të mos miratohen leje ndërtimi, pa përfunduar dhe miratuar më parë plani territorial vendor nga autoritetet përkatëse sipas standardeve teknike e procedurale, të përcaktuara në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në funksion të tij.

Menjëherë

11. Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë, të bashkëveprojnë për të verifikuar objektet në 9 rastet e konstatuara për të cilat lejet e ndërtimit janë miratuar por nuk janë zbardhur e tërhequr nga personat e interesuar si dhe nuk janë paguar detyrimet në vlerën 2,245,355 lekë .

Menjëherë

12. Të rishikohet me mirëkuptim ndërmjet palëve, dhe në se nuk arrihet të ndiqet në rrugë gjyqësore, kontrata me objekt "Shërbimi i pastrimit të qytetit Peqin"e lidhur me operatorin [redacted] sh.p.k. datë 15.2.2012, për argumentimin e volumeve faktike të punimeve, duke ju referuar vërejtjeve të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, dhe në përfundim, nëse konstatohen volume fiktive, të korrigjohen e të ndryshohen në kontratë.

Menjëherë

13. Të rishikohet urdhri i titullarit nr. 11. datë 15.2.2011 "Për emërimin e mbikëqyrësit të shërbimit publik të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave" dhe për caktimin e tij të veprohet sipas kritereve të përcaktuara në pikën 7 të VKM nr. 319, datë 21.6.1994 "Për prokurimin në sipërmarrje të shërbimeve publike të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave".

Menjëherë

14. Nga Inspektoriati Ndërtimor i Bashkisë, të hartohen planet vjetor për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e ndërtimit" dhe neneve 3, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me ndryshime.

Menjëherë

15. Nga Drejtoria e Urbanistikës së bashku me Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik të ushtrohen kontrolle të vazhdueshme për ndërtimet pa leje dhe të mos lejohet fillimi i punimeve nga ana e banorëve të juridiksionit të bashkisë pa u pajisur me leje ndërtimi, duke i dhënë rëndësinë e duhur të ligjit të urbanistikës dhe zbatimit të tij.

Vazhdimisht

16. Të inventarizohet dokumentacioni që përmbajnë Dosjet e Inspektoratit ndërtimor dhe urbanistik dhe të dorëzohen në zyrën e arkivit të Bashkisë,sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Rregullores së nxjerrë për këtë qëllim.

Menjëherë

17. Nga Drejtoria e Urbanistikës, të mos miratohen lejet e shfrytëzimit nga 21 persona në shumën 108,095 lekë, sipas listës bashkangjitur, pa u arkëtuar më parë detyrimet për diferenca të llogaritura për taksën e ndërtimit dhe të ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën **750,473 lekë**, duke ndjekur të gjithë procedurat administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, nga:

1.Tre ish punonjës të administratës së Bashkisë në vlerën 167.215 lekë si diferencë e përfituar më tepër në pagesat, detyrë e lënë nga kontrollet e mëparshme megjithëse të kontabilizuara në llogarinë 468 "Debitor të ndryshëm" të pa arkëtuara, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8270 datë 23.12.1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit" ndryshuar me ligjin nr. 8599 datë 01.06.2000, me nenin 11 pika b të ligjit nr. 9720 datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" me ndryshime dhe me Urdhrin e Kryeministrit nr. 70 datë 18.04.2006 "Për masat në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në Institucionet në vartësi të Kryeministrit a të Ministrave ".

2. Operatori ekonomik [redacted] në vlerën 245,405,50 lekë përfituar më tepër në situacionin e muajit Gusht 2011, e pajustifikuar dhe e pa argumentuar me dokumentacion ligjor

3. 21 persona në vlerën 108,095 lekë paguar më pak nga llogaritja e lejeve të ndërtimit për taksë të ndërtimit dhe të ndikimit në infrastrukturë, sipas listës bashkëngjitur.

4. Operatori ekonomik [redacted] në vlerën 52,800 lekë si diferenca të ndryshimit të projekt preventivit të punimeve në objektin rikonstruksion i rrugës [redacted] nga të cilat 44,000 lekë punime direkte dhe 8,800 lekë TVSH.

5. Tre mbikëqyrës dhe kolaudatorë punimesh ndërtimi në vlerën 176,958 lekë si diferencë e përfituar më tepër nga llogaritja më tepër për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit dhe konkretisht:
a. [redacted] në vlerën 140,580 lekë nga të cilat : vlera prej 44,585 lekë për mbikëqyrjen e punimeve në n/objektin "Ndërtim rezervuari 1000 m3" të objektit "Furnizim me ujë të pijshëm të qytetit Peqin" dhe vlera prej 95,995 lekë për mbikëqyrjen e punimeve në objektin "Rikonstruksion i rrugës së varrezave të qytetit Peqin".
b. Shoqëria e Kolaudimit [redacted] në vlerën 26,385 lekë për kolaudimin e punimeve në objektin "Furnizim me ujë të pijshëm të qytetit Peqin".
c. [redacted] në vlerën 9,993 lekë për mbikëqyrjen e punimeve objektin "Rikonstruksion i rrugës së varrezave të qytetit Peqin"

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Halil Isufi dhe Margarit Stefa. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT